



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA STIMLJE / MUNICIPALITY OF SHTIME



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Menaxher i Personelit
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët
Koeficienti/Paga	9.5
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	24/05/2023
Afati për aplikim	08/06/2023 - 15/06/2023
Institucioni	Komuna Shtime
Departamenti	Zyra e Kryetarit
Divizioni	Njësia e Burimeve Njerëzore
Vendi i punës	Komuna e Shtimes
Nr. i Referencës	RN00011743
Kodi	RPC0005349



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Zhvillon politikat dhe planet e autoritetit punëdhënës mbi menaxhimin e personelit
2. Udhëheq procesin e planifikimit, vlerësimit dhe rekrutimit të personelit si dhe menaxhon dhe mirëmban sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore .
3. Monitoron efikasitetin e sistemit të vlerësimit të përmbushjes së detyrave në punë dhe siguron standard të qëndrueshme raportuese
4. Këshillon Kryesusin e autoritetit punëdhënës dhe menaxheret e ti apo sajë për praktikatat të barabarta të punësimit dhe arritje të baraspeshës në mes gjinive dhe etnive
5. Miraton kërkesat që kanë të bëjnë me menaxhimin e personelit dhe që janë jashtë kompetencave të menaxherve drejtues
6. Menaxhon njesinë e personelit dhe zhvillon zotësinë personale të stafit menaxhues të personelit. Monitoron procedurat dhe praktikatat e autoritetit punëdhënës dhe siguron se ato përputhen me ligjin e shërbimit civil të Kosovës dhe legjislatcionet pesuese
7. Bashkpunon dhe siguron informata me menaxherët e personelit në autoritetet tjera punëdhënëse me qëllim të ngritjes së profesionalizmit të funksionit të personelit ne gjith shërbimin civil të Kosoves
8. Kryen edhe punë tjera ne kuader te planifikimit te tije-saj sipas kerkeses te kryetarit te komunes, per punen e tije saj njofton kryetarin e komunes

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve- Fakulteti Juridik/Ekonomik/Psikologji, Administratë Publike, Pedagogji;
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislatcionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjislatcionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon divizionin;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të divizionit/departamentit.



Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

